



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE

Nr. 3405 Prot

Vlore, më 20.03 2023

PROJEKT – VENDIM
Nr. _____, datë _____. 2023

**“PËR MIRATIMIN E MËNYRËS SË REALIZIMIT DHE FONDIT FINANCIAR VJETOR
SHITESË TË SHËRBIMIT TË PASTRIMIT PËR QYTETIN E VLORËS DHE NJËSITË
ADMINISTRATIVE”**

Bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b të Kreut III, neni 64 pika c të Kreut X, pika 1/3 c, neni 23 pika 10, nenet 34 dhe neni 54 pika dh, në VKM Nr 625 date 28.09.2022 “ Per disa shtesa dhe ndryshime ne VKM nr.165 datë 02.03.2016 “ per Grupimin e njesive te veteqeverisjes vendore, per efekt page, dhe caktimin e kufijeve te pagave te funksionareve te zgjedhur e te emeruar, te nepunesve civile e te punonjesve administrative te njesive te veteqeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, VKB nr 87, datë 23.12.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Deleguara - 2023”, VKB Nr. ____, date _____. 2023 “Për Miratimin e Planit Vendor te Menaxhimit te Integruar te Mbetjeve”, VKB Nr 87, datë 23.12.2022, “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Deleguara - 2023”, V.K.B Nr.1, dt.18.01.2023 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2023” Kontrata me Nr. 5227/1 Prot, datë 03.07.2020 “Shërbimi i Pastrimit ne qytetin Vlorë (03.07.2020 -02.07.2023); Ligjin Nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “ Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore“ neni 32, 40; VKM Nr.319, datë 21.6.1994 “Për prokurimin me sipërmarrje te shërbimeve publike te pastrimit dhe grumbullimit te mbeturinave”, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga administrata e Bashkisë Vlore;

VENDOSI

1. Të miratojë fondin vjetor shtesë 7.178.521 (shtatëmilion e njëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e njëzetë e një mijë lekë) me tvsh për efekt të rritjes së pagës minimale sipas VKM-së Nr.113, datë.01.03.2023 “Për caktimin e pagës minimale në shkallë vendi” si pjesë të fondit prej 26,314.000 të miratuar në buxhetin e vitit 2023 në zërin pastrim për Njësine Administrative Orikum në funksion të procedurës së prokurimit për një afat 1 deri 3 vjet te shërbimit te pastrimit për Njësine Administrative Orikum.
2. Të miratojë fondin vjetor prej 8.288.766 lekë (tetë milion e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë lekë) me tvsh për efekt të rritjes së pagës minimale sipas VKM-së Nr.113, datë.01.03.2023 “Për caktimin e pagës minimale në shkallë vendi” si pjesë të fondit prej 29,473,000 të miratuar në buxhetin e vitit 2023 në zërin pastrim për Njësine Administrative Novosel,

Shushicë, Qëndër në funksion të procedurës së prokurimit për një afat 1 deri 3 të shërbimit të pastrimit për Njësitë Administrative Novoselë, Shushicë, Qendër.

3. Të miratojë transferimin e fondit financiar të parashikuar në buxhetin e Bashkisë Vlorë të vitit 2023 sipas vlerës së llogaritur në analizën financiare për realizimin e shërbimit të pastrimit të qytetit Vlorë nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike (shtet).
4. Analiza e kostos së Shërbimit të pastrimit të qytetit të Vlorës dhe Njësive Administrative është e vlefshme deri në ndërtimin dhe vendosjen në funksion të Landfillit të Sherishtës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë Vlorë.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.

Urci: L. Tokiriq AP
D. Geroz. E
F. Selmani



KRYETAR
Dritan Eeli





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE

Nr. 3405/ Prot

Vlore, më 20.03 2023

PROJEKT – VENDIM
Nr. _____, datë _____. 2023

**“PËR MIRATIMIN E MËNYRËS SË REALIZIMIT DHE FONDIT FINANCIAR VJETOR
SHITESË TË SHËRBIMIT TË PASTRIMIT PËR QYTETIN E VLORËS DHE NJËSITË
ADMINISTRATIVE”**

Bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b të Kreut III, neni 64 pika c të Kreut X, pika 1/3 c, neni 23 pika 10, nenet 34 dhe neni 54 pika dh, në VKM Nr 625 date 28.09.2022 “ Per disa shtesa dhe ndryshime ne VKM nr.165 datë 02.03.2016 “ per Grupimin e njësive te veteqeverisjes vendore, per efekt page, dhe caktimin e kufijeve te pagave te funksionareve te zgjedhur e te emeruar, te nepunesve civile e te punonjesve administrative te njësive te veteqeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, VKB nr 87, datë 23.12.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Deleguara - 2023”, VKB Nr. ____, date _____.2023 “Për Miratimin e Planit Vendor te Menaxhimit te Integruar te Mbetjeve”, VKB Nr 87, datë 23.12.2022, “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Deleguara - 2023”, V.K.B Nr.1, dt.18.01.2023 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2023” Kontrata me Nr. 5227/1 Prot, datë 03.07.2020 “Shërbimi i Pastrimit ne qytetin Vlorë (03.07.2020 -02.07.2023); Ligjin Nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “ Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore“ neni 32, 40; VKM Nr.319, datë 21.6.1994 “Për prokurimin me sipërmarrje te shërbimeve publike te pastrimit dhe grumbullimit te mbeturinave”, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga administrata e Bashkisë Vlore;

VENDOSI

1. Të miratojë transferimin e fondit financiar të parashikuar në buxhetin e Bashkisë Vlorë të vitit 2023 siaps vlerës së llogaritur në analizën financiare per realizimin e shërbimit te pastrimit të qytetit Vlorë dhe Njwsive Administrative nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike (shtet).
2. Analiza e kostos së Shërbimit te pastrimit te qytetit te Vlorës dhe Njësive Administrative është e vlefshme deri ne ndërtimin dhe venien ne funksion të Landfillit të Sherishtës.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë Vlorë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.

Konceptoi : S.Haxhiraj

D. Zëraj

Z. Selmani

KRYETAR

Dritan Leli





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE

Nr. 3405 Prot

Vlorë, më 20.03 2023

RELACION

**“PËR MIRATIMIN E FONDIT VJETOR TE SHERBIMIT TE PASTRIMIT PER
QYTETIN E VLORES DHE NJESITE ADMINISTRATIVE”
ANALIZA E KOSTOVE PËR SHËRBIMIN E PASTRIMIT NË QYTETIN E VLORES
DHE NJESITE ADMINISTRATIVE**

Të nderuar këshilltarë,

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b, të Kreut III, neni 54 pika ç, Kreu IX, neni 64, pika c të Kreut X, po parashtrojmë për miratim projekt vendimin si më poshtë:

Në kuadër të projektit të “Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, Bashkia Vlorë ka përfituar makineri dhe pajisje për shërbimet e pastrimit, përfshirë kontejnerë për grumbullimin e mbetjeve, ka përfituar trajnimin e punonjësve në lidhje me menaxhimin e integruar të mbetjeve, si dhe do të ndërmarrë masa dhe aktivitete për informimin, ndërgjegjësimin dhe angazhimin e qytetarëve dhe bizneseve në proceset e menaxhimit të mbetjeve. Bashkia ka mundësuar vendosjen e 1115 kontejnerëve të rinj për grumbullimin e mbetjeve, si dhe do të mundësojë instalimin e 50 kontejnerëve nëntokësorë në 25 pika, në zonën turistike të Lungomares, dhe vendosjen e 100 kontejnerëve depo për mbledhjen në mënyrë të diferencuar të mbetjeve të riciklueshme.

Ofrimi i shërbimeve të pastrimit të Bashkisë deri në datën 02.07.2023 është i kontraktuar me Sipërmarrje Private. Duke marr shkas nga perfundimi i afatit të kësaj kontrate, Bashkia kërkon kalimin e kryerjes së shërbimit të pastrimit në qytetin e Vlorës nga sipërmarrje në shërbim të vetë, pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike (NSHP), nëpërmjet Sektorit të Pastrimit të Ndërmarrjes.

NSHP ka marrë në dorëzim një numër pajisjesh për shërbimet e pastrimit të cilat do të jenë në funksion të këtij sektori.

Mjetet që janë marrë në dorëzim nga NSHP janë:

- Një (1) mjet për pastrimin e plazhit. Turizmi dhe rrjedhimisht plazhet në funksion të zhvillimit të turizmit cilësor, luajnë një rol kyç për ekonominë e Bashkisë Vlorë. Përdorimi i këtij mjeti do të mundësojë pastrimin e plazheve në mënyrë të rregullt dhe efektive. Plazhet e pastra do të rrisin promovimin e Vlorës si destinacion turistik.
- Tre (3) mjete transportuese me dopiokabinë për punonjësit e NSHP të Bashkisë Vlorë, do të përdoren për transportin e punonjësve dhe pajisjeve të pastrimit të mbetjeve në drejtim të dhe nga zonat e shërbimit të pastrimit nga mbetjet.
- Një (1) kamion i hapur dhe një (1) fadromë. Fadroma do të përdoret për pastrimin e vend depozitimeve të paligjshme të mbetjeve, pastrimin e brigjeve të lumenjve.

- Një (1) kamion me vinç dhe 100 kontenerë depo. Kontenerë depo për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të riciklueshme do të vendosen në Rajonin nr. 3 të Qytetit të Vlorës, në kuadër të projektit pilot i cili do të ndihmojë në uljen e volumit të mbetjeve që do të shkojnë në landfillin e Sherishtës. në arritjen e objektivave të strategjisë kombëtare të mbetjeve dhe planit vendor të mbetjeve të Bashkisë Vlorë, në rritjen e të ardhurat e Bashkisë dhe në mbështetjen e industrisë së riciklimit.
- Dy (2) kamionë autofshesë (2m3 dhe 5m3). Këto autofshesa do të rrisin cilësinë e pastrimit dhe të ajrit. Ato do të përdoren edhe në fshirjen e rrugëve të asfaltuara të tjera që nuk mbulohen nga shërbimet e pastrimit të operatorëve privatë.
- Gjashtë (6) kamion kompaktor (20 m3) për mbledhjen e mbetjeve.
- Gjashtë (6) kamion kompaktor (10 m3) për mbledhjen e mbetjeve.
- Katër (4) kamion (6 m3) për mbledhjen e mbetjeve. Kamionët kompaktor do të përdoren për grumbullim të mbetjeve urbane në pikat e koshave të caktuara nga Bashkia, si dhe mbetjeve përreth koshave deri në distancën prej 4m nga koshi.
- Një (1) kamion me vinç.

Nga administrata e Bashkisë është llogaritur analiza e kostos së këtij shërbimi duke reflektuar ndryshimin e çmimit të karburantit dhe rritjen e pagës minimale në bazë të VKM Nr.113, dt.01.03.2023, për “Përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”. Grupi i punës ka bërë dy variante të analizës së kostos, nëse ky shërbim do të kryhet shtet apo privat. Nga krahasimi i të dy varianteve: kemi për variantin shtet fondin prej 265.289.432 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë milion e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e tridhjetë e dy) lekë, ndërsa për variantin privat fondin prej 296 221 459 (dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e njëzetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë me tvsh. (sipas analizës bashkëlidhur).

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë në bazë të shqyrtimit dhe vlerësimit të miratojë mënyrën si do të realizohet ky shërbim në vazhdim.

Shërbimi i pastrimit aktualisht në Bashkinë Vlorë realizohet me shërbim me sipërmarrje me 3 kompani. Qyteti i Vlorës, Njësia Administrative Orikum dhe Njësitë Administrative Novoselë, Shushicë, Qendër.

Për sa më lart realizimi i shërbimit të pastrimit në qytetin e Vlorës, synon të ngrejë në nivel me cilësor realizimin e këtij shërbimi. Shërbimi i pastrimit të mbetjeve urbane, në vetvete përmban disa komponentë. Në studimin e hartuar qëllimi primar është ofrimi i shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin e Bashkisë së Vlorës në cilësinë maksimale si ndaj qytetareve dhe biznesit ashtu dhe ndaj turistëve. Këtë përmirësim cilësor në ofrimin e shërbimit e mundësojnë gjithashtu dhe investimet e kryera në infrastrukturën e qytetit këto vite. Investimet kanë konsistuar në zgjerimin e rrjetit rrugor në parametrat e kërkuar, ku përfshihen Shëtitorja “Lungomare”, rruga “Poliklinika – 7 pallatet”, “7 Pallatet – Dhimiter Konomi”, Rruga Sazani, Rruga Transballkanike, rruga Ramize Gjebrea (Unaza), e rrugë të tjera të rikonstruara. Rikonstruksioni i plote i 6 blloqeve të banimit, të cilët deri më tani nuk kanë pasur cilësinë e duhur për ofrimin e shërbimit të pastrimit.

Gjithashtu numri në rritje i turistëve të cilët nga viti në vit shtohen në Bashkinë e Vlorës, ku sipas statistikave numri i popullsisë gjatë pikut të sezonit turistik dyfishohet.

Për sa më lart studimi ka marrë në konsideratë kërkesat për ofrimin e shërbimit duke bërë vlerësimin e kostove përkatëse për këtë shërbim bazuar në dispozitat ligjore të ligjit nr.8094 date 21.03.1996 "Për largimin publik të mbeturinave", ku janë të përcaktuara qarte parimet e përgjithshme:

1. Mënjanimin e çdo dëmi a rreziku për shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e jetës së personit.
2. Garantimin e kërkesave higjeno-shëndetësore dhe çdo rrezik ndaj ndotjes së ajrit, ujit, tokës e nëntokës.
3. Të ruajë e të mbrojë faunën e florën dhe degradimin e mjedisit e të peizazhit.

Gjithashtu hartimi i këtij studimi është bazuar dhe ne projektin për “Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta” i cili mbulon pjesën veriore të Rajonit të Vlorës, përkatësisht Bashkitë e Vlorës dhe të Selenicës. Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është dhënia e kontributit për një menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve të ngurta, përmes investimeve në infrastrukturë dhe mbështetjen institucionale për dhënien e një shërbimi të përmirësuar në pjesën veriore të rajonit të Vlorës. Në këtë mënyrë mbështetet strategjia kombëtare e mbetjeve si dhe harmonizimi i standarteve me ato të Bashkimit Europian (BE) si edhe përmirësohen kushtet e jetesës së popullsisë, gjithashtu edhe kushtet mjedisore.

Sistemi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta, i cili do të zbatohet do të jetë i plotë si nga ana mjedisore ashtu edhe nga ajo teknike në bazë të standarteve të BE. Për më tepër ai do të përshtatet me nevojat dhe kapacitetet në zonën ku do të shtrihet projekti përta i përket menaxhimit institucional, operimit dhe mirëmbajtjes së landfilleve dhe të gjithë ambjenteve/godinave respektive si edhe të përshtatet me mundësitë financiare të banorëve të zonës ku do të shtrihet projekti.

Ekspertet e konsulentit kanë punuar gjatë gjithë kësaj periudhe me specialistet e Bashkisë Vlore ne hartimin e këtij studimi, pjese te këtij studimi janë te dhënat qe janë përdorur ne llogaritjen e kostos.

Ne llogaritjen e kostos për periudhën e ofrimit të shërbimit të pastrimit është bazuar ne metodologjinë aktuale te kontratave ekzistuese (Ngarkim, transport mbeturine; fshirja e rrugëve dhe shesheve; larje dhe lagje e rrugëve; sistemim mbeturina ne fushat ekzistuese), por duke reflektuar edhe ndryshimet në çmimin e karburantit dhe rrogës minimale.

Ne baze te ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 23 “Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”, pika 10; bashkitë jane përgjegjëse ne territorin e juridiksionit te tyre per “Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.” si dhe ligjit 8094/1996 “Per largimin publik te mbeturinave” i ndryshuar; bashkia nëpërmjet strukturave përgjegjëse organizon mbledhjen dhe largimin e mbeturinave nga persona fizikë e juridikë, publikë e privatë të përzgjedhur nëpërmjet procedurës së prokurimit publik, që janë të specializuar në shërbimet e pastrimit dhe grumbullimin e mbeturinave si dhe ka per detyre te:

- Caktimin e koshave, kazanëve e stacioneve të betonit në pika të caktuara për dorëzimin e mbeturinave.
- Përcaktimin e metodave dhe teknologjive që përdoren ose do të përdoren për largimin publik të mbeturinave;
- Miratimin e rregullores për shërbimin e pastrimit publik dhe ndarjen territoriale në zona pastrimi të bashkisë;
- Lidhjen e kontratave të pastrimit me sipërmarrësit për çdo zonë pastrimi;
- Caktimin dhe mbledhjen e taksës për pastrimin.

Ne llogaritjen e kostos se këtij shërbimi, në kuptimin e këtij ligji “**Mbeturina**”, janë lëndët ose objektet që dalin nga veprimtaritë njerëzore, ekonomi shtëpiake të braktisura a që janë të destinuara për braktisje. Në kuptim të këtij ligji me emërtimin “mbeturina” përfshihen:

- a) Papastërtitë që dalin nga shtëpitë e banimit, mbeturinat e kuzhinës, rrecka, cifla, kanoçe, hi, blozë, plastike etj.
- b) Papastërtitë që dalin nga lokalet.
- c) Papastërtitë që dalin nga kopshtet, lulishtet dhe oborret funksionale të ndërtesave publike (lokale, restorante) etj.
- ç) Papastërtitë që dalin nga ndërmarrjet private e shtetërore, të shkaktuara nga prodhimi, si ai artizanal, tregtar, i shërbimeve etj.
- d) Papastërtitë që dalin nga ndërtimet e ndryshme, si rëra, dhera etj., që janë në masa të parëndësishme sa 1/10 m³.

Nuk përfshihen në llogaritjen e kostos dhe nuk përfshihen në largimin publik të mbeturinave:

1. Mbetjet radioaktive.
2. Mbetjet nga puna kërkimore, industria nxjerrëse e përpunuese e trajtimit dhe e grumbullimit të pasurive minerare të shfrytëzimit të vendburimeve të ndryshme.
3. Toka, balta, bora, akulli, fekalet, mbeturinat që vijnë nga lëndë të shuara ose të nxehta.
4. Mbeturina zanati, papastërtitë e stallave, kadavrat, lëngjet, mbetjet e vajrave lubrifikante e të benzinës.
5. Lëngjet eksplozive, substancat gërryese, mbetjet e ngjyrave e të karbiteve.
6. Ngordhësit.
7. Mbetjet bujqësore.
8. Lëndët shpërthyes dhe eksplozive.
9. Materialet fekale.
10. Mbetjet nga ndërtimet dhe meremetimet e objekteve e të veprave me përmasa mbi 1/10 m³.
11. Lëndët materiale të tjera që ndodhen jashtë vijës kufizuese të qyteteve a komunave, si dhe lëndë e materiale të tjera që parashikohen e disjelojnë me ligje të veçanta.
12. Mbeturinat e tjera të çdo lloji që gjatë largimit të tyre shkaktojnë dëmtime dhe mund të vënë në rrezik organizma që merren me largimin e tyre, nxjerrin në ajër lëndë të ndryshme, sjellin shkatërrime etj.
13. Klasifikimi dhe përcaktimi konkret i mbeturinave dhe i natyrës së tyre do të bëhet në rregulloren e shërbimit të pastrimit.

Shërbimet e analizuar në kuadër të këtij studimi janë: heqje mbeturinash urbane dhe inerte, fshirje dhe larje rrugësh, dhe numrin e koshave, kazanëve e stacioneve të betonit në pika të caktuara për dorëzimin e mbeturinave. Secili prej tyre ka veçantitë dhe karakteristikat e veta në ndikimin e realizimit të këtij shërbimi. Në rrugët e kategorisë së parë e të dytë janë të vendosur kontejnerë me kapacitet 1,1 m³, ndërsa për zonat e rrugës së kategorisë së tretë e të katërt në zonat periferike të qytetit janë kontejnerë me kapacitet 1,7 m³.

Analiza e kostos është krijuar mbi bazën e një eksperience të gjatë të Bashkisë Vlorë, duke marrë për bazë shumë elemente të domosdoshme për këtë analizë të kostos. Në funksion të këtij studimi

jane hartuar skicat e rrugëve dhe shesheve te Bashkisë Vlorë qe jane objekt i ketij shërbimi, si dhe skica e vendit te grumbullimit te mbetjeve.

Tabela e mëposhtme jep koeficientet e llogaritjes se ditëve te punës ne vit për efekt te llogaritjes se pagës ne baze te Kodit te Punës (ore nate, dite pushime, dite festa).

A							
nr	muaji	Njesia	dite pune	pushim	festa	totali	
1	janar	dite	21	8	2	31	
2	shkurt	dite	20	8		28	
3	mars	dite	20	9	2	31	
4	prill	dite	20	8	2	30	
5	maj	dite	20	10	1	31	
6	qershor	dite	21	8	1	30	
7	korrik	dite	23	8		31	
8	gusht	dite	20	10	1	31	
9	shtator	dite	21	8	1	30	
10	tetor	dite	22	9	0	31	
11	nentor	dite	19	9	2	30	
12	dhjetor	dite	21	8	2	31	
	totali	dite	248	103	14	365	
B 1	Konvertohet turni I nates per 365 - 50 % (ngarkim, transport)		dite	248	103	14	182.5
B 2	Konvertohen festat dhe pushimet me 50 % (sistemim mbeturina)				103	14	58.5
B 3	Konvertohen turni I nates per 26 dite ne muaj (314 dite ne vit, fshirja)			248	51.5	14	157.0
B 4	Konvertohen turni I nates me 50 % (larje turn nate dite pune)			228			114.0
C	Totali I diteve						
C 1	Totali I diteve B1			248	103	14	547.5
C 2	Totali I diteve B2				103	14	423.5
C 3	Totali I diteve B3			248	51.5	14	405.0
C 4	Totali I diteve B4			228			342.0
D	Dite pune per 1 punonjes ne vit 11 muaj(248-20)		dite	228			228.0
E	Numri I punonjeve (totali I ditev /dite per 1 punonjes E= C1 /D)		punonjes				2.40
	Numri I punonjeve (totali I ditev /dite per 1 punonjes E= C2 /D)		punonjes				1.86
	Numri I punonjeve (totali I ditev /dite per 1 punonjes E= C3 /D)		punonjes				2.07
	Numri I punonjeve (totali I ditev /dite per 1 punonjes E= C4 /D)		punonjes				1.50

Nga studimi i përbashkët i zhvilluar nga Bashkia Vlore dhe Konsulenti Institucional kemi analizën e tregueseve te mëposhtëm:


	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Netor	Dhjetor
Numri i ditëve	31	28	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31
Shpërndarja e trafikut turistik						15%	35%	35%	15%			
Shpërndarja e sasisë së mbeturinave						389.9	909.7	909.7	389.9			
Mbetje shtesë në ditë						13.00	29.34	29.34	13.00			
Numri i qëndrimeve gjatë natës						241,921	554,432	554,432	241,921			
Shpërndarja e popullsisë	70%	75%	80%	85%	100%	130%	155%	155%	130%	90%	80%	70%
Popullsia në muajin aktual	109,110	116,904	124,698	132,491	155,872	202,634	241,602	241,602	202,634	140,285	124,698	109,110
Sasia e mbetjeve ditore	98	105	112	119	140	182	217	217	182	126	112	98
Sasia e mbeturinave ditore duke përfshirë mbajtjet e turistave	98	105	112	119	140	195	247	247	195	126	112	98

Nga tabela e mësipërme mesatarja ditore totale 140 ton/ditë ne qytetin e Vlorës.

Aktualisht qyteti i Vlorës ka afërsisht 147 500 banorë dhe 4900 subjekte biznesi. Këto statistika janë bazuar ne te dhënat e Gjendjes Civile. Si qytet bregdetar me sektorin e turizmit ne zhvillim jane marre parasysh ne këtë studim dhe numri i turisteve, ku sipas te dhënave nga burime te ndryshme, numri i ditëve te qëndrimit llogaritet ne rreth 1.6 milione dite qëndrimi (turiste te huaj dhe vendas).

Kontenierët janë vendosur kryesisht në blloqet e banimit, rrugë kryesore, apo në pika të vecanta, kurse në zonat periferike ekzistojnë edhe pika grumbullimi të mbetjeve që nuk ka kontenierë por që heqja kryhet me mjete transporti (në analizën e kostos janë parashikuar mjetet teknologjike, mjetet e transportit, fadroma për heqjen e mbetjeve).

Sipas analizës për arsye te hapësirave dhe te mos spostimit te kontejnerëve do te vendosen ne total 800 kontejnerë ne 600 pika në qytetin e Vlorës. Për periudhën e sezonit do te kete mbledhje te mbeturinave 1 here ne dite ne kushte normale dhe 2 herë në ditë për gjatë sezonit turistik (per tu detajuar sipas rrugëve dhe ngarkesës). Gjatë sezonit turistik do të ketë edhe brigada punëtorësh të përbërë nga 15-20 persona të dedikuara për zona të vecanta, sikurse është zona e Lungomares, Unaza e Qytetit, Rruga Dhimitër Konomi, etj.



Ne këtë shërbim përfshihet edhe fshirja e rrugëve, trotuareve dhe shesheve. Rrugët dhe sheshet e kategorisë se pare e te dyte do fshihen me autofshese, kurse trotualet e rrugeve te kategorise se pare, rrugët e kategorisë se trete e te katërt do te fshihen me punëtore.

Tabela analitike e rrugëve qe përfshihen ne kontrate për qytetin e Vlorës

	Siperfaqe Totale m2	Fshihen me autofshese m2	Fshihen me puntor m2	Rr. Qe Lahen Sip. m2
RRUGE	802,143	162,442	289,561	417,170
SHE SHE	97,547	25,600	71,947	46,324
BLLOQE	196,402		196,402	-
TOTALI	1,096,092	188,042	557,910	463,494



Nr.	Rrugë	Gjatesia m (L)	Kontrata e Re Sip. m2	Trotuar (m2)	Rr. Qe Fshihen me Autofshes Sip. m2 (L X 2 X 1.5)	Puntor Sip. m2 Trotuar (L X 2 X 1.5)	Rr. Qe Lahen Sip. m2
1	ALEKSANDER MOJSIU	1,207	13,347	3,549	3,621	3,549	9,798
2	ALI DEMI	625	8,901	3,714	1,875	3,714	5,127
3	ANDREA VARFI	1,480	16,280	5,920	-	10,360	-
4	ANITA BITRI	212	5,936	2,756	-	3,119	3,180
5	ARANIT SERBI	278	3,058	1,112	-	1,946	-
6	ATE KRISTO NEGOVANI	1,040	9,900	3,000	3,120	3,000	6,900
7	BILAL GOLEMI	240	1,920	480	-	830	-
8	BULEVARDI ISMAIL QEMALI	1,670	69,050	53,200	58,210	-	15,850
9	CENO SHARRA	70	426	90	-	300	-
10	DALAN DADANI	122	732	-	-	366	-
11	DEMOKRACIA	620	16,100	7,200	1,860	7,200	8,900
12	DERVISH HEKALI	599	3,861	-	-	1,797	2,500
13	DESHMORET	302	3,825	1,560	905	1,560	2,265
14	DHIMITER KONOMI	1,860	21,850	6,850	5,580	6,850	15,000
15	DRASHOVICA	515	2,225	-	-	1,545	-
16	DUSH STRATI	650	9,343	3,755	1,950	3,755	5,588
17	ENVER JAHO	677	11,782	4,830	-	6,861	6,952
18	FAN NOLI	409	3,830	-	-	1,227	-
19	FEJZO MEMA	260	2,293	834	-	1,614	-
20	FIQIRETE MUSTA	212	2,312	828	636	828	1,484
21	FEJZO GJOMEMA	139	2,293	834	417	834	1,459
22	GJERGJ ARANITI	444	9,883	3,223	1,332	3,223	6,660
23	HAJREDIN DANUSHI - OSMEN HAXH	409	7,217	3,564	1,227	3,564	3,653
24	HAJREDIN HAXHIRAJ + YMER RADHI	618	8,598	3,360	1,854	3,360	4,400
25	HAMZA ISAI	940	8,340	820	2,820	820	-
26	HASAN KUSHTA	465	11,904	4,464	1,395	4,464	7,440
27	HEKTOR SHYTI	139	2,293	834	417	834	1,459
28	HYSNI ALIMERKO	350	5,810	1,610	1,050	1,610	4,200
29	ILIRIA	133	1,542	532	-	931	-
30	IRFAN SHEHU	302	1,510	-	-	906	-
31	ISMET ÇAKERRI	190	950	-	-	570	-
32	JANAQ KILICA	270	6,480	2,430	810	2,430	4,050
33	JANI BOÇARI	203	708	-	609	-	-
34	JERONIM DE RADA	421	2,357	-	-	1,263	-
35	JUSTIN GODAR	225	1,120	220	-	895	-
36	KASTRIOT GJINI	327	4,578	2,289	-	3,270	-
37	KOSOVA	338	13,595	5,483	1,014	6,497	8,112
38	KOSTANDIN KRISTOFORIDHI	160	1,120	-	-	480	-
39	LAZE MALO	300	1,208	-	-	900	-
40	LEF SALLATA	362	2,701	891	-	1,977	1,810
41	LIDHJA TRANSBALLKNIKE -AUTOSTE	1,445	38,000	7,300	4,335	7,300	30,700
42	LIDHJA UNAZE-UII I FTOHTE	920	6,920	1,400	2,760	1,400	5,520
43	LIRIA	133	1,652	532	399	532	-
44	LUNGOMARE	2,920	108,400	79,200	8,760	79,200	29,200
45	MAHMUDE LAGII	225	2,300	550	-	1,225	-
46	MEHMET PETOSHATI	397	1,588	-	1,191	-	-
47	MIS DURHAN	1,278	11,325	2,556	3,834	2,556	8,772
48	MISTO MELE	413	6,559	2,225	-	3,464	4,334
49	MITAQ SALLATA	246	1,942	100	-	838	1,842
50	MITAT DAUTI	235	2,245	-	-	705	-
51	JANI VRETO	270	1,134	-	-	810	-
52	MUSTAFA MATOHITI	300	1,500	-	-	900	-
53	MULLA XHAFFERI	155	930	-	-	465	-
54	MUSTAFA BELLO	323	4,027	2,100	969	2,100	1,927
55	NERMIN VLORA FALASKI	533	5,429	1,909	1,599	1,909	3,520
56	PAVLO FLOKO	370	2,627	740	-	1,850	-
57	PELIVAN LESKAJ	890	12,361	5,446	2,670	5,446	6,915
58	PILO BEGAJ	212	3,306	1,113	-	1,476	2,193
59	PRENJO PETOSHATI	1,154	6,347	-	-	3,464	-
60	PUSI I MEZINIT	1,324	11,094	900	3,972	900	-
61	RAKIP MALILE	235	5,640	2,115	-	2,820	3,525
62	RAMIZE GJEBREA - GJON BOÇARI - G	2,701	28,128	6,520	8,103	6,520	21,608
63	RIZA SALATI	213	4,622	1,491	-	2,130	3,131
64	PERLAT REXHEPI	228	3,078	912	684	912	2,166
65	SAZANI + PARKIMI	2,360	34,040	8,740	7,080	8,740	25,300
66	RRUGA TRANSBALLKNIKE	2,300	75,000	12,000	6,900	12,000	63,000
67	UNAZA	4,150	54,900	13,600	12,450	13,600	41,300
68	SHEFIT ZENAJ	840	6,390	200	-	2,720	-
69	TASIM JONUZI	174	2,442	891	-	1,413	1,551
70	TASIM RAKIPI (TREGU)	130	1,280	-	-	390	1,280
71	VELEDIN KOLLOZI	320	5,934	2,574	-	3,534	3,360
72	XHEBRO GJIK	380	3,040	1,140	1,140	1,140	1,900
73	XHEMIL BEJ VLORA	981	8,614	2,100	2,943	2,100	-
74	ZAHIR PAJAZITI	648	5,184	1,296	-	3,240	-
75	ZAHO KOKA	351	8,656	3,040	-	4,094	5,616
76	ZENEL GJOLEKA-VASIL TALO-LIKE SE	1,938	17,318	495	-	6,309	16,823
77	ZIGUR LELO	650	7,010	2,110	1,950	2,110	4,900
	Totale		802,140	295,527	162,442	289,561	417,170

Tabela per sheshet ne qytetin e Vlores

Nr.	EMËRTIMI	Sipërfaqe (m ²)	Kontrata Ekzistuese (m ²)	Kontrata e Re (m ²)	Sip. Qe Fshihen me Autofshes (m ²)	Sip. Qe Fshihen me Puntor (m ²)	Sip. Qe Lahen (m ²)
1	SH. I ABELLS (RRETH-RRROTULLIMI) - SH. PAVARSIA	17015	17015	17015	5000	12015	5000
2	SHESHI PARA BUSTIT ISMAIL DEMALI	4585	4585	4585	0	4585	4585
3	SHESHI MIDIS STADIUMI-PALLATI I SPORTIT	6560	6560	6560	4000	2560	6560
4	SHESHI TE FABRIKA E TULLAVE LULISHTJA	5939	5939	5939	2000	3939	
5	SHESHI PARA BASHKISE VLORE-4 HERONJTE	2664	2664	2664	2000	664	
6	SHESHI I FLAMURIT	12000	12000	12000	1000	11000	
7	SHESHI TRE RACAT	2950	0	2950	0	2950	0
8	SHESHET NE HYRJE TE LUNGOMARES	6679	0	6679	0	6679	0
9	SHESHI TE RRUGA-URA NE LUNGOMARE	780	0	780	0	780	0
10	SHESHI TE P.T.T	4530	4530	4530	0	4530	
11	SHESHI PERBALLE UNION B. NE BULEVARD	170	0	170	0	170	0
12	SHESHI TE SHELGU NE BULEVARD PERBALLE CONAD	380	0	380	0	380	0
13	TERRENET SPORTIVE NE FUND TE LUNGOMARES	13200	0	13200	0	13200	0
14	BULEVARDI ISMAIL DEMALI(TROTUARE)	53200	0	53200	0	0	53200
15	SHESHI NE KEND TE RRUGES MUSTAFA BELLO	95	0	95	0	95	0
	TOTALE	130747	53293	130747	14000	63547	69345

Tabela per Blloqet e banimit

Nr.Rend	EMËRTIMI	RRUGË + TROTUARE	Kontrata Ekzistuese (m ²)	Kontrata e Re (m ²)	Sip. Qe Fshihen ME Puntor (m ²)
		Sipërfaqe totale (m ²)			
1	BLLOKU KOMBINATI	14600	0	14600	14600
2	BLLOKU PARKU AULONA	29300	0	29300	29300
3	BLLOKU CONAD	8162	0	8162	8162
4	BLLOKU 10 KORRIKU 1-2	24250	0	24250	24250
5	BLLOKU PERBALLE SHKOLLES HALIM XHELO(Demokracia)	5330	0	5330	5330
6	BLLOKU I SIGURIMEVE SHOQERORE	10850	10850	10850	10850
7	BLLOKU TE XHAMIA	4324	4324	4324	4320
8	BLLOKU TE TRE RACAT	7050	7050	7050	7050
9	BLLOKU TE TREGU I ORIZIT	6515	6515	6515	6515
10	BLLOKU TE GJENDIA CIVILE	6638	6638	6638	6638
11	BLLOKU MARIGO POSJO	7050	7050	7050	7050
12	BLLOKU PAS SHKOLLES HALIM XHELO	3000	3000	3000	3000
13	BLLOKU DESHMORET,KASTRIOT GJINI	4000	4000	4000	4000
14	BLLOKU KASTRIOT GJINI - HYSNI ALIMERKO	3000	3000	3000	3000
15	BLLOKU PAS SHKOLLES MJEKESORE	8600	8600	8600	8600
16	BLLOKU ISA BOLETINI	21000	21000	21000	21000
17	BLLOKU TE POSTA E ÇOLES	6290	6290	6290	6290
18	BLLOKU PAS SHKOLLES INDUSTRIALE	7950	7950	7950	7950
19	BLLOKU TE ISH SERAT	9000	0	9000	9000
20	BLLOKU TE 4-KATESHET	9493	9493	9493	9493
	TOTALE	196402	105760	196402	196398

Pika e depozitimit te mbetjeve ndodhet ne zonën e Jallise Narte.



Ne baze te te dhenave dhe studimeve te deritanishme eshte kryer analiza e koston me qellim nxjerrjen e fondit qe do te vihet ne dispozicion te shërbimit.

BAZA LIGJORE

Baza ligjore mbi te cilen eshte mbështetur kjo analize kosto eshte si me poshte:

1. Ligji nr.139/2015 "Per vetëqeverisjen Vendore".
2. Ligji nr.8094 date 21.03.1996 "Per largimin publik te mbeturinave".
3. Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise i miratuar me ligjin nr.7961 dt.12.07.1995, i ndryshuar.
4. Ligji nr.10 431, datë 9.6.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar.
5. VKM nr.809 dt.26.12.2018 "Per përcaktimin e pages minimale ne shkalle vendi".
6. VKM Nr.319, datë 21.6.1994 "Per prokurimin me sipërmarrje te shërbimeve publike te pastrimit dhe grumbullimit te mbeturinave".
7. VKM nr. 510, datë 10.6.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial" (kreu III pika 2)
8. Urdher nr.180 dt.21.08.2019 "Per ngritjen e grupit te punës per matjen e sipërfaqeve te rrugëve, shesheve dhe blloqeve te banimit me infrastrukture te rregullt ne qytetin e Vlores".
9. VKM 717/2009 - Për Pagat E Punonjësve Mbështetës Të Institucioneve Buxhetore Dhe Të Nëpunësve Të Disa Institucioneve Buxhetore I Përditësuar (Shkalla 1).
10. VKM nr.319 datë 31.05.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve"
11. VKM nr. 625, datë 28.09.2022 " Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.165, datë 02.03.2016 "Për Grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijëve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar,
12. VKM NR.113 date 01.03.2023 per " Përcaktimin e pages minimale ne shkalle vendi"

ANALIZA E KOSTOS SE SHERBIMIT PER PASTRIMIN URBAN QYTETI VLORE


1. ANALIZE KOSTO QYTETI VLORE PËR SHËRBIM ME SIPËRMARRJE

SHERBIMI 1 : “Ngarkim, transport mbeturina“ (140 ton/dite, 1100 kontenierë/dite)

Qëllimi i punës: Heqja periodike e mbeturinave nga pikat e grumbullimit me kontejnerë metalike dhe kosha betoni në gjithë qytetin, si dhe transportimi i tyre ne fushën e grumbullimit. Ky shërbim do te kryhet nga ora 22.00-06.00 te çdo dite te vitit.

Përshkrimi i punës:

- Mjetet e transportit te mbeturinave sipas destinacionit te caktuar kryejnë transportin e mbeturinave nga qyteti ne fushën e grumbullimit.
- Punëtorët e transportit kane për detyre te heqin te gjithë mbeturinat familjare nga pikat e grumbullimit, te bëjnë fshirjen me fshese dhe dezinfektimin me gëlqere te vend grumbullimit me nje rreze prej 3 ml.
- Transporti i mbeturinave nga qyteti deri ne fushën e grumbullimit.



Per përpunimin e 140 ton mbeturina Bashkia Vlore nga 1100 kontenierë. (Subjektet pjesëmarrëse ne planbiznesin e paraqitur, mund planifikojnë te rrisin numrin e kontejnerëve brenda pikave te miratuara nga Bashkia).

Për heqjen e sasisë se mbetjeve prej 140 ton ne dite (51 100 ton ne vit), duke u nisur nga eksperiencia e mëparshme ne lidhje me shtrirjen e shërbimit, nevojiten auto teknologjike te kapacitetit 8 - 15 m³, per arsye se ne zona te caktuara është e pamundur hyrja e automjeteve me kapacitet me te madh se 8 - 10 m³, por njëkohësisht ekzistojnë zona qe shërbimi mund te kryhet edhe me auto 15 m³. Ne një mesatare te kesaj analize nevojiten auto me kapacitet mesatar 12 m³.

Nga eksperiencia e deritanishme, nje auto me kapacitet mesatar 12 m³ (me kapacitet 8 - 15 m³) heq 44 - 45 konteniere (ketu duhet te kihet ne konsiderate edhe kompatimi i mbetjeve qe kryen makina teknologjike, por qe nga eksperiencia e Bashkisë Vlore është nxjerre kjo mesatare).

Koha (t) per boshatisjen e nje pike (kontenieri) 5 minuta. (2' per boshatisje, 1 minutë per dizinfektim - fshirje, 2 minuta per levizje nga nje pike ne tjetren.).

Koha mesatare nga qyteti deri ne fushën e grumbullimit, vajtje 10 minuta, shkarkim 5 minuta, kthim 10 minuta gjithsej 25 minuta/rruge.

1 rrugë ne total

50 konteniere x 4.5 minuta (Ngarkim + sistemim + levizje)

+ 25 minuta rruga (Vlore – fushe grumbullimi, vajtje ardhje + shkarkim, depozitim)

= 250 minuta/rrugë x 2 rrugë = 500 minuta per dy rrugë

Për efekt te llogaritjes merren 480 minuta

Për çdo mjet teknologjik, pervec shoferit është e nevojshme te jene 2 punetore shoqerues te cilet, do te merren me zbrazen e kontejnerëve, heqjen e mbetjeve te hedhura jashte konteniereve, me dezinfektimin e pikes se grumbullimit te mbetjeve, fshirjen e kontenierit etj. Per dezinfektimin e konteniereve nevojiten rreth 100 g (0.1 kg) dezinfektant ne dite.

Ne vazhdim te ketij sherbimi, nga praktika e kontrates ekzistuese funksionin dhe nje miniskuader qe pastron mjediset publike si dhe ben heqjen e mbetjeve solide (inerte) nga pikat e grumbullimit te mbeturinave ne qytet. Puna e kesaj skuadre do te konsistoj ne:

- Pastrimi i mjedisit ndermjet pallateve dhe qendrave te banuara dhe transportimi i tyre.
- Pastrimi dhe transportimi i dherave e mbetjeve te tjera inerte ne afërsi te pikave te grumbullimit.

Per heqjen e dherave te dale nga gërryerjet nevojiten te jene ne dispozicion dy auto me kapacitet mesatar 800 kg - 1,5 t, ku ne dispozicion te saj përveç shoferit te jete edhe 1 punëtor, si dhe nje auto per kontrollin e realizimit te gjithë punës. Ky shërbim do te kryhet nga ora 8.00-16.00 te çdo dite.

Ne funksion te ketij shërbimi jane llogaritur shpenzime te ndryshme për pjese nderimi, goma, vaj, karburant, vegla pune, rroba pune, antidote etj te cilat janë bere pjese e analizës se kosos. Për llogaritjen e tyre janë mare për baze normativat e përdorura nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Bashkia Vlore.

8 auto teknologjike x 365 dp/vit:12muaj = 244 dp/muaj. Për shkak se ky shërbim do te kryhet ne te gjitha ditët e vitit, bazuar ne dispozitat e Kodit te Punes mendohet te parashikohen edhe dy ndërrues te shofereve.

2 fadromist + 2 shofera = 4 *365/12 = 121 dite pune / muaj

3 auto X 365 dp/muaj X 26 dp/muaj = 78 dp/muaj.

Gjithsej **443 dp/makin/muaj**.

Ne total per kryerjen e shërbimit te heqjes dhe transportit te mbetjeve nevojiten 15 mjete, per te cilat parashikohen shpenzimet e mëposhtme:

V.O: per 3 shofera + 2 punëtorë te miniskuadres se pastrimit, koeficienti (Numri i punonjësve (totali i diteve /dite per 1 punonjes E = C /D) eshte 2.35 (103 ditepushimi + 14 dite festa = 117 dite*1.5 + 248 dp vit = 423.5/228 = 1.86)

1	Page shofera 8 shof/teknol + 16 punetore = $24 \times 2.4 \times 40\,000$ leke	2304000
	Page shofera 2 shof/fadrom + 2 shof/kamiontore = $4 \times 2.4 \times 40\,000$ leke	384000
	Page shofera 3 shof + 2 punt = $5 \times 1.86 \times 40\,000$	372000
2	Kontribute 3060000 leke $\times 16.7\%$	511020
3	Dizinfektant (gelqere) 401500 pika/vit. $\times 0.1$ kg/pike $\times 22$ lek/kg /12 muaj	73608
4	Vegla pune. lopata fshesa etj, 42 punëtorë $\times 650$ lek/muaj ($16 \times 2.4 + 2 \times 1.86$) = 42 punëtor	27378
5	Pjese kembimi kontejnerë 800×0.1 rrota/muaj $\times 1600$ lek/rrota	128000
6	Karburanti I- 8 auto $\times 365$ dp/vit:12muaj = 244 dp/muaj $\times 47$ lit = $11\,468$ lit II – 2 fadroma - $\times 365$ dp/vit:12muaj = 61 dp/muaj $\times 60$ lit = 3660 lit III – 2 kamiona/20 ton - $\times 365$ dp/vit:12muaj = 61 dp/muaj $\times 50$ lit = 3050 lit IV-3 auto = 78 dp/muaj $\times 20$ lit = $1\,560$ lit Shuma I + II + III + IV = $19,738$ lit $\times 151.6$ lek/lit	2992280.8
7	Goma auto. 8 auto $\times 6$ goma/vit $\times 20\,000$ lek/gome : 12 muaj = $80\,000$ 2 fadroma $\times 4$ goma/vit $\times 50\,000$ lek/gome : 12 muaj = $33,330$ 2 auto $\times 6$ goma/vit $\times 20\,000$ lek/gome : 12 muaj = $20\,000$ 3 auto $\times 4$ gom/vit $\times 10\,000$ lek/gome : 12 muaj = $10\,000$	143330
8	Pjes kemb.auto. 365 dp/muaj $\times 600$ lek/dp	219000
9	vaj hidraulik. $8 + 2 + 2$ mjete Nderim vaji cdo 1000 ore pune, cdo 4 muaj = 3 her/vit $\times 12$ = 36 auto 36 auto $\times 130$ lit/auto = 4680 lit, 3 auto $\times 100$ l/vit = 300 lit 4980×264 lek/lit : 12 muaj	109.560
10	Vaj motori. 15 auto $\times 6$ lit/muaj $\times 419$ lek/lit	37710
11	Rroba pune. 33 pale/vit $\times 4920$ leke : 12muaj	13530
12	Antidode. 33 punëtorë $\times 1335$ leke/muaj	44055
	Totali mesatar mujor	7250021.3

TOTALI LEK/muaj **7 250 021 leke**

Strukture & fitim 18% 1 305 004 leke

Shuma lek/muaj 8 555 025 leke

Shuma leke/vit 88 305 256 leke

Kosto për ton - vlere vit 88 305 256 leke/vit / 51 100 t/vit = 1729 leke/ton

Kosto për ton - vlere vit 88 305 256 leke/vit / 401500 konteniere/vit = 220 leke/konteniere/dite

Pjese e këtij shërbimi do të jete dhe heqja e mbetjeve të hedhura jashtë kontejnerëve, në sheshet publike, sheshet përpara godinave të banimit, në lulishte trotuare, etj.

Pjese e këtij shërbimi është edhe larja dhe pastrimi i kontejnerëve i cili do të përcaktohet në kontratë.

SHERBIMI 2: “Fshirje e rrugëve dhe shesheve” (745 952m²/dite, 232 737 024 m² / vit).

Qyteti i Vlorës është një qytet ku sipërfaqja totale e trajtuar me fshirje duhet të rritet, kjo perkon edhe me zgjerimin e tij. Sipërfaqja totale e trajtuar me fshirje është **745 952m²** të ndare në pesë rajone. Ky shërbim do të kryhet nga ora 23.00 - 07.00 për 26 dite pune në muaj.

Sipas studimit të kësaj sipërfaqe do të jete :

	Sipërfaqe Totale m ²	Fshihen me autofshese m ²	Fshihen me puntor m ²	Rr. Qe Lahen Sip. m ²
RRUGE	802,143	162,442	289,561	417,170
SHE SHE	97,547	25,600	71,947	46,324
BLLOQE	196,402		196,402	-
TOTALI	1,096,092	188,042	557,910	463,494

Kjo sipërfaqe është llogaritur në total, por gjatë zbatimit të kontratës mund të ketë ndryshime të shesheve, rrugëve, trotuare pa ndryshuar sipërfaqen totale.

Qendra e qytetit apo edhe zona e tjera që do të kryhet ky shërbim do të përcaktohen/detajohen në kontratë, nga Bashkia e Vlorës sipas rastit dhe nevojave të përditshme/përmuajshme që do të krijohen.

Ndarja e këtij procesi (me krahë dhe me autofshese) është kryer për arsye të pamundësisë praktike të kryerjes me proces të mekanizuar, për shkak të parkimit të automjeteve apo edhe shkaqeve të ndryshme. Nga praktika e deritanishme është provuar që shërbimi i fshirjes me autofshese ka qenë i vështirë për vetë kushtet e rrugëve, apo vështirësitë etj si trafiku, niveli i kunetave etj. Ky shërbim në rast të paraqitjes së vështirësive të kësaj natyre do të konsiderohet shërbim ndihmës brenda sipërfaqes totale prej 745 952 m² në ditë. Kjo do të thotë që subjekti sipërmarrës analizën e koston do ta konsiderojë si një proces të vetëm (në varësi të efikasitetit të shërbimit brenda sipërfaqes dhe fondit të parashikuar në këtë analizë).

a. Fshirje me mjet teknologjik

Qëllimi i punës : Rrugët dhe sheshet e kategorise se pare e te dyte qe llogariten me nje sipërfaqe prej rreth 188,042 m²/dite do të kryhet fshirja me mjet teknologjik (autofshese), pasi kërkojnë një shërbim me cilësor. Ky shërbim do të kryhet për të eliminuar pluhurin dhe për të përmirësuar me shumë cilësine e pastrimit të rrugëve në qendër të qytetit.

Bazuar në kontratat e mëparshme një autofshese mund të realizojë fshirjen e një sipërfaqe prej 8000m²/ore ose rreth 64 000 m² për 8 ore. Ky shërbim do të kryhet me 3 autofshesa që do të fshijnë 64 000 m² secila për vetë kushtet që kanë rrugët kryesore të zena nga parkimet e makinave. Secila prej autofshesave për veç shoferit do të ketë në dispozicion edhe një punëtor.

Nr.	Shpenzimi	Vlera
1	Karburant 3 autofsh x 26 dp/muaj x 60 lit/dit x 151.6 leke/lit	709488
2	Fshesa. 3 autofsh x 1,5 komplet/muaj x 70 000 leke/kompleti	315000
3	Punetore (3shofer+3punetore) x 2 x 40 000 leke	480000
4	Kontribut 480000 x 16.7%	80160
